



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2022:051102

Datë: 23.05.2024

Numri i dokumentit: 05726239

**C.nr.924/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Edije Sezairi**, me praktikanten gjyqësore M.D. në çështjen juridike kontestimore të paditëses D.M. me numër personal .... nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson M.Sh. avokat nga Prizreni, kundër të paditurës QKMF në Prizren, me objekt të padisë kompensimin e pagave jubilarë, jashtë seance, me datë **23.05.2024**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**për shkak të padëgjueshmërisë mosbindjes**

- I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses D.M. nga Prizreni, **DETYROHET** e paditura, QKMF në Prizren, që paditëses në emër të shpërblimit jubilar për mbi 11 vite përvojë pune, ti paguaj shumën e përgjithshme prej 425.00 € (katërqind e njëzetë e pesë), në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- II. **DETYROHET** e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124.00 € (njëqind e njëzetë e katër), në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm

**A r s y e t i m**

Paditësja D.M. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj M.Sh. avokat nga Prizreni, pranë kësaj gjykate, me datën 18.03.2022, ka parashtruar padi, kundër të paditues QKMF në Prizren, me objekt të padisë kompensimin e pagës jubilarë.

I autorizuari i paditëses në padi ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, e përcaktuar në vendin e punës si asistente e drejtorit. Paditësja i është drejtuar palës këtu të paditurës për kompensimin e pagave jubilarë, e paraparë në Kontratën Kolektive Sektoriale të Shëndetësis të datës 12.06.2018. E paditura përmes përgjigjes së dt.13.07.2021, me nr.18/87, i ka refuzuar kërkesën e dt.08.06.2021 për kompensimin e pagave jubilarë, me arsyetimin se çështja e pagesës, mënyra e pagesës si dhe sigurimi i mjeteve financiare nuk është bërë akoma, nuk është rregulluar (me akt nënligjor), edhe pse kan kaluar 3 vite nga nënshkrimi i KKSSH ndërmjet palëve kontraktuese të cilat gjerë më tani nuk kanë marrë asgjë për të mundësuar ekzekutimin e kontratës. Në fund i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave, të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi me datë 08.11.2023, të cilën e paditura e ka pranuar me datë 13.11.2023 (e cila është konfirmuar përmes fletëdërgesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës).

Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënie të përgjegjës në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes - pa dëgjueshmërisë.

E paditura, pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale në këtë çështje juridike kontestuese, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, ka gjetur së në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë nga neni 150 paragrafi 1 pikat a), b) dhe (c) të LPK-së, nëse të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht.

Themelësia e kërkesëpadisë del nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, nga kontrata me numër 16/53, të datës 01.08.2019, e lidhur në mes të paditurës dhe këtu paditëses, nga vërtetimi me numër amzë A-758, të datës 19.04.2021, të lëshuara nga ana e drejtorit të QKMF në Prizren, ku vërtetohet se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura si asistente e drejtorit tek – QKMF në Prizren që nga, 03.08.2009 dhe ka gjithsej 11 vite, 08 muaj e 16 ditë përvoj pune në QKMF, duke realizuar pagë neto në vlerë prej 435.13 euro.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Shëndetësisë në Kosovë, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 11.06.2018.

Me nenin 17 par.3 nën par.3.2, të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë është paraparë se “Punëtorët shëndetësor në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: Për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy paga mujore të tij”.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si asistente e drejtorit t'ia paguaj kompensimin për paga jubilarë, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës.

Kontratën dhe vërtetimin e lartcekur, Gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”. Andaj meqë ky dokument është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cilat edhe si të tilla janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, ashtu që vërtetimit të lëshuar nga ana e Spitalit të Përgjithshëm “Prim.Dr.Daut

Mustafa” në Prizren, si provë me të cilat vërtetohet fakti lidhur me vitet e punësimit, gjykata ia falë besimin e plotë.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (22.07.2021), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Gjykata, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke i’u referuar dispozitës së nenit 150 par.1 pika a, b, dhe c të LPK-së, e në lidhje me dispozitat e nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017 dhe datës 22.01.2021 dhe dispozitave të nenit 245 par.1 dhe 2, neni 249 par.1 dhe 2 të LMD-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni civil**  
**C.nr.924/22 23.05.2024**

**Gj y q t a r j a**  
**Edije Sezairi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.